



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. **110**

Prishtinë, më 22.4.2013, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-302

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Liburn Aliu, Rasim Demiri, Sevdije Lama, Afërdita Berisha-Shaqiri, Salih Morina, Nijazi Idrizi.

Mungoi: Boban Todorović, Daut Haradinaj.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: sipas listës së nënshkruar nga pjesëmarrësit.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi dhe Flaka Broqi.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite :

1. Miratimi i rendit të ditës ;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 15.4.2013,
3. Mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit nr.03/L-214 për Vlerësimin e ndikimit në mjedis,
4. Mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit nr.03/L-230 për Vlerësimin strategjik mjedisor,
5. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 15.4.2013

Kryetari i Komisionit konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 15.4.2013.

3. Mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit nr. 03/L-214 për Vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe Mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit nr.03/L-230 për Vlerësimin strategjik mjedisor

Kryetari Nait Hasani njoftoi komisionin se grupi punues për monitorimin e Ligjit për VNM dhe VSM ka përgatitur dy dokumentet me shkrim për të përcjellë në miratim mbledhjes plenare, paraprakisht sugjeroi të epet fjala udhëheqësit të GP **Liburn Aliut** i cili theksoi se këto monitorime kanë zgjatur më tepër sesa duhet, por ka pasur edhe arsye për vonesë ngase është dashur të pritët rezultati nga MMPH rreth ndalimeve të eksploatimit të zhavorrit në lumenj si dhe projekti i Brezovicës të përfshihet në raport. Ai ceku se raportet janë rezultat i vizitave në terren dhe posaçërisht duhet të potencohet fakti se Ligji për VNM asnjëherë nuk mundet të zbatohet plotësisht në terren sepse qysh nga fillimi i ndërtimit të një objekti, lëshimit të lejes dhe fazave tjera parashtrihen funksionet që nuk mund të përfundojnë tërësisht. Sa i përket Ligjit për VSM, monitorimi është kryer duke falënderuar REC e cila ka organizuar tryeza të ndryshme nëpër komuna dhe janë shfrytëzuar shënimet nga ato takime. Ky ligj në praktikë zbatohet më tepër sesa Ligji për VNM ngase planet hapësinore të komunave duhet të përmbajnë VSM. Ai sugjeroi komisionin që mund të vendos sot për të përcjellë këto ligje për mbledhje plenare, por mund edhe të shtyhet për javën tjetër deri kur mund të dërgohen vërejtjet konkrete nga anëtarët e komisionit. Komisioni pasi që bëri ca ndërhyrje teknike në rekomandimet përfundimtare nxori :

P Ë R F U N D I M

MIRATOHEN dy monitorimet nga Komisioni për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për VNM dhe VSM, të cilat pasi të plotësohen me vërejtjet e mbledhjes së sotme do të dërgohen në procedim për mbledhjen e radhës plenare.

5. Të ndryshme

Kryetari Nait Hasani në këtë pikë njoftoi për planet e komisionit në ditët në vijim :

- më 7 maj mbahet debati publik në EMERALD për dy projektligje (ndërtimet pa leje dhe planifikimi hapësinor) me mbështetjen e projektit BEEP ku parashihet të ftohen mysafirët dhe atë ditë të pyeten për vërejtje për të dy projektet,
- më 17 maj komisioni viziton Korçën dhe dy vende tjera me mbështetjen financiare të ZRRUK,
- komisioni në fillim të majit të vizitoi Deçanin dhe Prevallën,
- kryetari i komisionit në fillim të muajit maj viziton Sllovenin,
- grupi punues për hartimin e ligjit për ZRRUK do të takohet në numrin më të vogël sesa është komisioni, për shkak të punës më të shpejt dhe do të bëhen përpjekjet të përfundoj punën derisa kryhet vizita në Shqipëri.

Mbledhja përfundoi në orën 13,10

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,

Nait Hasani

